

Data 05.09.2023

**STATUT
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SDS1 ” SH.P.K.**

**Kreu I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1
Forma ligjore dhe emri i shoqërisë**

“SDS1” Sh.p.k është themeluar bazuar në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, si dhe në Aktin e Themelimit të Shoqërisë, nënshkruar nga dy ortakë.

“SDS1” Sh.p.k është themeluar dhe funksionon si shoqëri tregtare e formës “me përgjegjësi të kufizuar” (sh.p.k.). Nga këtu e më poshtë në këtë statut shoqëria “SDS1” Sh.p.k do referohet shkurtimisht si shoqëria.

Shoqëria fiton personalitetin juridik si dhe të drejtën për të kryer veprime dhe të marrë përsipër të drejta dhe detyrime gjatë aktivitetit të saj të përditshëm , që nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria e realizon aktivitetin e saj, sipas objektit të përcaktuar në këtë statut, bazuar në legjislacionin shqiptar, Statutin dhe Aktin e Themelimit.

**Neni 2
Ortakët e shoqërisë**

Shoqëria është themeluar nga nje ortakë:

- **Z.Durim Pirraçi**, i datëlindjes 21.03.1983 , i lindur në Macukull, Burrel dhe banues në Kamëz, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i indentifikua rnga pasaporta me nr. **I30321121P**, me nr.telefoni 069 95 15 454.

Neni 3

Kohezgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë te pacaktuar e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të ortakut të vetëm, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky Statut.

Neni 4

Selia

Selia e Shoqërisë “SDS1” Sh.p.k. do të jetë në Rruga “Co Plan”, Ndertesa 50,H1,Bathore,Kamez,1054.

Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

Neni 5
Objekti i aktivitetit

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “SDS1” Sh.p.k do të jetë:
Konstruksione metalike

Kreu II
KAPITALI DHE KUOTAT
Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “SDS1” Sh.p.k është 3,000,000 (Tre milion) Lekë.

Kapitali themeltar është i ndarë në 1(një) kuotë, me vlerë 3,000,000 lekë secila.

- **Z.Durim Pirraçi** me 100% apo 1 (nje) kuote, 1 kuota x 3,000,000/lekë secila.

Neni 7
Regjistri i kuotave të kapitalit themeltar

Kuotat dhe zotëruesi i tyre, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me kuotat e kapitalit themeltar, regjistrohen në një regjistër të posaçëm.

Forma dhe modalitetet e tjera të regjistrimit miratohen me vendim të ortakëve.

Në rast të zotërimit të kuotave të shoqërisë nga më shumë se një ortak forma dhe modalitetet e tjera të këtij regjistri miratohen me vendim të ortakëve që zotërojnë jo më pak se 80% të kuotave të pjesmarrjes.

KREU III

Të drejtat dhe detyrat e Ortakëve:

Neni 8

Ortakët gëzojnë këto të drejta kryesore

- Pjesëmarrjen në rezultatet e cdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
- Marrjen e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarinë e shoqërisë, si dhe me të gjithë dokumentat e përpunuara nga shoqëria, bilancet si dhe llogaritë ekonomike, etj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga mbledhja e përgjithshme e Asamblesë dhe organet e tjera të shoqërisë.
- Të heqë dorë nga shoqëria.
- Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ortakët nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
- Të marri pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesit të tij ose vetë.
- Të kërkojë ti jepen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen prodhuese dhe tregtare të shoqërisë, si dhe të gjithë dokumentat e përpunuara të shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike, etj.
- Të emërojnë dhe të shkarkojnë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

Neni 9

Ortakët kanë këto detyrime kryesore

- Të depozitojë kuotën e tij dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë ai.
- Ti japë Shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e cdo objekti të vecantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria duke i njoftuar vendimin e tij asamblesë 6 muaj përpara dhe duke ceduar të drejtën e zgjedhjes sipas nenit.
- Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ortakët nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
- Ti japi shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.
- Pjesëmarrja në shoqëri nuk i pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore për veprimtari të tjera dhe për të drejta të tjera pronësie. Ai nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë që rrjedhin nga objekti i veprimtarisë së saj të kapitalit themelor ku ata kanë marrë pjesë.

KREU IV

Kushtet Ekonomike

Neni 10

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda 31 marsit të vitit pasardhës. Çdo vit financiar fillon me 1 janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Neni 11

Llogaritë vjetore Inventari, raportet operacionet e veprimtarisë së vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 12

Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë, vihet një kapital bazë që përbën burimin fillestar për krijimin e fondit themelor dhe të mjeteve të xhiros.

Neni 13

Kur Shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të ardhurave i marrin ortakët themelues.

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, pasi zbriten të gjitha detyrimet si edhe fondet e lëna rezervë për nxitjen ekonomike, për investimet, për reklamën tregtare etj. përfitohen prej ortakëve themelues të kësaj shoqërie.

Ortakët përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tyre të derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të tij ortakët kanë të drejtën e rritjes së tij.

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie në rast ndarjeje pasurie ndërmjet bashkëshortëve dhe nëpërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohet me akt noterial.

Shoqëria në emër të vet është pronare, përdoruse dhe disponuse e pasurive të saj, por gjithmonë në përputhje me qëllimin e objektin e veprimtarisë që ajo kryen.

Shoqëria mund të shesë pasuri ose të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale. Ajo mund të ofrojë për garanci edhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare.

Shoqëria krijon fonde rezervë ose dhe fonde të tjera të vecanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.

Neni 14

Shoqëria është pronare e pasurive të saj dhe ka të drejtë të përdorimit dhe disponimit të kësaj pasurie, në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë që kryen. Shoqëria gëzon të drejtat për mbrojtjen e pasurisë së saj në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Neni 15

E ardhura bruto e shoqërisë, pasi zbritet amortizimi i të gjithë pasurisë së luftshme e të paluftshme, sipas afateve të caktuara, kuotat që kanë të bëjnë me kreditë për investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet për lëndët e para apo ndihmëse e energjinë si dhe shpenzimet e përgjithshme të saksioneve të shoqërisë dhe ato për qëllime të tjera prodhuese e joprodhuese, i takojnë ortakëve të shoqërisë.

Kreu V

Administrimi

Neni 16

Organi vendimtar i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret nga Administratori, nga eksperti kontabël i autorizuar. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mbledhet dhe merr vendime me përfaqësuesit e jo më pak se 80% të kuotave të pjesmarrjes. Asambleja e Përgjithshme vendos: për çështje të tilla si emërimet ose shkarkimet e personelit sipas strukturave të ngritura nga shoqëria ekspertin kontabël të autorizuar dhe likujduesit, miratimin e raporteve të administrimit dhe kontrollit, për: miratimin e programit vjetor të veprimtarisë së shoqërisë për çështje të tilla si ndryshimin e statutit, zvogëlimin e pjesëve të kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar, shndërrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në forma të tjera, mbylljen e shoqërisë para kohe.

Neni 17

Për çështjet që vijnë Asambleja e Ortakëve merr vendime eskuzive me 80% të kuotave të pjesmarrjes:

1. Përcaktimi i të drejtave kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Ndryshime në emërtesën e projekteve që do të realizohet dhe të punimeve që do të kryhen, që janë pjesë përbërëse e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.
3. Propozimet e nevojshme për ndryshimet në kapitalin bazë të shoqërisë.
4. Përcaktimi i regjimit dhe i kushteve të zbatimit të parimeve të llogarisë ekonomike.
5. Përcaktimi i rregullave dhe i normave, që përkufizon raportet me gjirin e shoqërisë duke përfshirë edhe kuadrin e personelit.
6. Përcaktimi i strukturës së aparatit të shoqërisë.
7. Përcaktimi i organikës dhe ndarja e vendeve drejtuese ndërmjet përfaqësive të ortakëve.
8. Emërtimi dhe zëvendësimi i administratorit të përgjithshëm të shoqërisë.
9. Krijimi i organeve të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
10. Përcaktimi i madhësisë të kuotave për formimin e kapitalit bazë të shoqërisë.
11. Paraqitja e propozimeve për rregullimin, krijimin dhe përfitimin nga fondet e veçanta, ndarja e fitimeve dhe përcaktimi i rregullave për shlyerjen e borxheve.
12. Marrja e vendimeve për krijimin e filjaleve të degëve dhe të përfaqësive si dhe për çedimin e veprimtarisë së tyre.
13. Përcaktimi i rregulloreve për procedurën e punës të administratës.
14. Përgatitja e propozimit për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë.
15. Përzgjedhja e antarëve për komisionin e likuidimit të cilët emërohen dhe rivokohen nga asambleja e ortakëve.
16. Kryerjen e veprimtarive për likuidimin e llogarive, që i përkasin ortakëve dorëhequr të shoqërisë.
17. Marrja e vendimit për kërkimin dhe përdorimin e kredive afatgjata.

Neni 18

Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj. Në shoqërinë “SDS1” Sh.p.k Administratori i shoqërisë do të jetë: **Z.Durim Pirraçi**, i cili në të njëjtën kohë ka dhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në gjithë veprimtarisë së saj. Me miratimin e ortakëve mund të emërohen administratorë dhe përfaqësues të shoqërisë “SDS1” Sh.p.k

Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej pesë vjetësh financiare me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose shkarkimit të përkohshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statusit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

Kompetencat e administratorit në shoqëri janë:

Të miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në kuadrin e veprimtarisë së shoqërisë.

- Të bëjë propozimet në mbledhjen e asamblesë kur lind nevoja e kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Të miratojë akt normative që përcaktojnë raportet në shoqëri duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
- Të përcaktoj strukturën e aparatit të shoqërisë.
- Të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- Të propozojë në mbledhjen e asamblesë për krijimin e njësisë, strukturave si filjale, degë e përfaqësi në qytete të tjera të vendit ose jashtë shtetit.

- Të përgatiti propozimet për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'ia paraqesin ato Asamblesë për miratim.
- Të përzgjedhi ekspertet kontabël dhe antarët e komisionit të likuidimit dhe të paraqesin propozimet për miratimin në asamble.
- Të sigurojë zbatimin e përpiktë të vendimeve të asamblesë.
- Të përcaktojë numrin e punonjësve të shoqërisë dhe pagat e tyre.
- Organizon punën për realizimin e planeve të shoqërisë dhe raporton për to në përputhje me programet e planet e përgjithshme, administron pasurinë e shoqërisë, duke përfshirë këtu mjetet financiare, brenda caqeve të vendimeve të marra nga organi administrative i shoqërisë.
- Drejton e kontrollon veprimtarinë e filialeve të degëve e të përfaqësive.
- Përfaqëson shoqërinë përpara të tretëve si gjykatë etj.
- Nënshkruan kontrata në emër e për llogari të shoqërisë dhe siguron vënien e tyre në jetë.
- Merr të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me ato veprimtari të shoqërisë, që nuk janë në kompetencë ekzekutive të Asamblesë së Ortakëve.
- Raporton dhe i përgjigjet asamblesë për zbatimin e veprimtarive të shoqërisë si dhe për realizimin e objekteve dhe detyrave që janë në kompetencë të tij.
- Siguron drejtimin e shoqërisë.
- Përfaqëson shoqërinë në lidhje me të tretët brenda caqeve të objektit dhe të veprimtarisë së saj, përveç çështjeve që kërkojnë unanimitetin e ortakëve ose që kanë të bëjnë me kompetencat që ky statut i atribuon asamblesë së ortakëve.
- Organizon zbatimin e saktë të vendimeve të asamblesë së ortakëve.

Neni 19

Për të kontrolluar veprimtarinë financiare të shoqërisë e të filialeve të saj krijohet komisioni i revizionimit kontabël.

Kryetari dhe anëtarët e këtij komisioni emërohen nga Asambleja e Ortakëve Kryetari i komisionit emërohet për cdo mandat nga Asambleja.

Komisioni i Revizionimit kontabël përbëhet nga 3-5 vetë dhe qëndron në detyrë për një periudhë prej tre vjetësh.

Kryetarin dhe anëtarët e komisionit nuk mund të jenë në varësi të shoqërisë ose filialeve të saj.

Komisioni i Revizionimit kontabël është përgjegjës për veprimtarinë e vet para Asamblesë së Ortakëve dhe është i detyruar ti paraqesë asaj cdo vit raport për kontrollet e bëra si dhe konkluzionet për bilancet vjetore.

Neni 20

Marrëdhëniet e punës në shoqëri

Marrëdhëniet e punës në shoqëri e filiale në degë e përfaqësitë rregullohen në përputhje me vendimin për krijimin e shoqërisë, legjislacionit shqiptar dhe me këtë statut si dhe nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjen që nuk rregullohen në kontratën e punës, zbatohen dispozitat e legjislacionit të punës. Punësimi i punonjësve në shoqëri bëhet mbi bazën e kontratës individuale të punës.

Në kontratën e punës rregullohen këto çështje:

- Kushtet dhe mënyra e marrëdhënies së punës.
- Fillimi i punës së punonjësve dhe caktimi i tij në vendin e punës.
- Koha e punës dhe caktimi i kohës së punës, puna e natës, puna jashtë kohës normale, puna në ditët e pushimit javor, festive zyrtare.
- Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës.
- Pushimet dhe mungesat, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Punonjësve për zbatimin e detyrave të punës.
- Pushimi i marrëdhënies së punës.
- Paga e punës së punonjësit, shpërblimi i punës dhe shpërblimet e tjera.
- Shoqëria merr përsipër të bëjë sigurimin e të punësuarve pranë saj në organet përkatëse duke derdhur rregullisht kontributet në përqindje të caktuara sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për shqyrtimin e tyre është Gjykata e rrethit Gjyqësor, Tiranë.

KREU VI

Mbyllja e shoqërisë

Neni 21

Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e ortakëve, kur gjatë dy vjetëve nuk rezulton rentabël ose kur ortakët heqin dorë nga shoqëria si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijimit të shoqërisë (kontrata). Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likuidimi.

Afati i veprimtarisë së shoqërisë caktohet e pakufizuar duke filluar nga viti **2023** si viti i parë i veprimtarisë.

Neni 22

Kur shoqëria likuidohet

Asambleja e ortakëve emëron likuidatorin, të cilit i paraqitet bilanci dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në castin e miratimit të këtij raporti të hartuar.

Pasuritë që janë vënë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi shiten në vartësi të shkallës së konsumit të tyre. Të ardhurat ndahen ndërmjet ortakëve në përpjestim me kuotën e vënë. Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë e të filialeve të saj dhe fondet financiare ndahen ndërmjet ortakëve në përpjesëtim me kuotat e vëna pasi të jenë bërë pagesat për kreditorët.

Neni 23

Kur pushon veprimtaria e një filiali, për efekt të riorganizimit të tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakëve. Likuidimi i filialeve bëhet njëloj si për shoqërinë. Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së filialit të likuiduara dhe fondet e tij financiare vihen në dispozicion të shoqërisë pasi t'u jenë bërë pagesat likuidatorëve.


Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky statut është i hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi me miratimin dhe pranimin e depozitimit të tij pranë Regjistrisë Tregtare.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Z.Durim Pirraçi

DURIM PIRRAÇI 

1